



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 50 datë 30.9.2021

**“PËR DHËNIE PËLQIMI PËR DHËNIE ME QIRA TË EKONOMISË PYJORE  
“PRUEMOS SHELDI”, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRETHINA, BASHKIA  
SHKODËR, NGA STRA 50 A, ME SIPËRFAQE 250 M2 , ME AFAT 5 VJECAR PËR  
VENDOSJEN E ANTENËS TË KOMUNKIMIT TË OPERATORIT TË  
TELEFONISË CELULARE “ONE TELECOMMUNICATIONS SH.A”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.9.2021, me propozim të Kryetares së Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, e ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar ; neni 12 i ligjit nr.57/2020 “Për pyjet”; VKM nr.433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” të ndryshuar ; VKM nr. 684, datë 02.09.2020 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.433, datë 8.6.2015 të Këshillit të Ministrave ‘Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”; pika 2 e VKM nr.391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” i ndryshuar ; pika 22, gema ‘g’ e Udhëzimit të Ministrisë Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” , si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

**V E N D O S I:**

1. Dhënie pëlqimi për dhënie me qira të ekonomisë pyjore “Pruemos Sheldi” njësi administrative Rrethina, Bashkia Shkodër , nga str. 50 a, me sipërfaqe 250 m2, me afat 5 vjeçar, për vendosjen e antenës të komunikimit celular të operatorit të

telefonisë celulare 'One Telecommunications' sh.a, sipas planimetrisë bashkëlidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

**K R Y E T A R**

  
Briseja KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak

  
Denis Lesha

Miratuar me 29 vota

Vota Pro 26

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 3

Zbardhur me datë 5.10.2021